

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>1</sup>	Objekti i kërkesës <sup>2</sup>	Data e përgjigjes <sup>3</sup>	Përgjigje <sup>4</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>5</sup>	Tarifa <sup>6</sup>
1	01.06.2020	Vënien në dispozicion të një kopje të dosjes së hetimit (- një kopje të vendimit/vendimeve në lidhje me inspektimin disiplinor. Një kopje të çdo dokumenti të grumbulluar gjatë procesit të inspektimit)për magistraten E.K; A.K; M.Q; E.T; A.K; A.M; A.H	08.06.2020	Referuar nenit 100 pika 2 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ILD udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm, proporcional dhe në mënyrë të balancuar të parimit të drejtësisë së hapur, të ligjshmërisë, konfidencialitetit, i të drejtës për jetë private dhe i mbrojtjes së të dhënave personale. Paralelisht me të drejtën e informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë shkon edhe mbrojtja e integritetit, figurës së magistratit, mbrojtja e interesave ligjore të personave të tretë. Në këtë kuadër, duke marrë në konsideratë moscënimin e funksionit dhe qëllimit të veprimtarisë së ILD-së, si edhe bazuar në parashikimet e nenit 17, pika 2, shkronja c, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", nuk mund ti vihet në depoziton informacioni i kërkuar në këtë moment.	Përfudnuar	Nuk ka
2	20.07.2020		23.07.2020	Prioritet i Zyrës së Inspektorit të lartë të drejtësisë është shqyrtimi dhe vlerësimi me seriozitet i të gjitha pretendimeve të	Përfunduar	Nuk ka

<sup>1</sup> Data e regjistrimit të kërkesës

<sup>2</sup> Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>3</sup> Data e kthimit të përgjigjes

<sup>4</sup> Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>5</sup> Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

<sup>6</sup> Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				paraqitura nga persona fizik dhe juridik lidhur me veprimet mosveprimet ose sjelljet e magistratëve brenda apo jashtë funksioni. Objekt i këtij shqyrtimi do jetë edhe rasti i referuar nga ana e z. M. B. Çdo pretendim i ngritur do shqyrtohet administrativisht nga ILD në përputhje me parashikimet e pjesës V, Kreu II të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe pala kërkuese do njoftohet për çdo vendim që do merret lidhur me këtë kërkesë		
3	17.08.2020	1. Kërkohet metodologjia e vlerësimit të dosjes së dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët në procedurat e konkurimit për pozicionin e ndihmës inspektorit. 2. Kopje të tabelave të vlerësimit të dosjes së dokumenteve për kërkuesen/kandidaten F. B. dhe për kandidatët fitues nga jashtë shërbimit civil. 3. Kopje të testimit me shkrim me vlerësimin përkatës për F.B. 4. Kopje të CV-së së kandidatëve nga jashtë shërbimit civil shpallur	25.08.2020	1. Metodologjia e vlerësimit me pikë të dosjes së dokumenteve të dorëzuara nga kandidatët është bërë bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015. 2. Çdo kandidat vlerësohet në mënyrë individuale bazuar në ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM-në nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, si edhe në kuadër të ruajtjes së konfidencialitetit nuk bëhen publike dhe nuk mund të vihen në dispozicion për kandidatët e tjerë në konkurim, ndërsa për formularin (tabelën e vlerësimit personal për znj. F.B. mund ta aksesoni në çdo moment pranë zyrave të ILD-së edhe pse ju është komunikuar me email e datës 5.08.2020 nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore. 3. Lutemi të paraqiteni pranë ambienteve të ILD-së për vënien në dispozicion të tezës me celsin për Përfunduar Nuk ka verifikimin e përgjigjeve. 4. Referuar ligjit nr.9887, datë	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		fitues		10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si edhe nenit 45 të Kodit të Procedurave Administrative, CV-ja ka të dhëna personale, të cilat mund të përbëjnë shkak për cënimin e privatësisë së kandidatëve dhe dhënia e këtij informacioni bëhet vetëm me pëlqimin e individit. Kandidatët fitues të cilët kanë filluar marrëdhëniet financiare pranë ILD-së, janë publikuar në adresën ëëë.ild.al. të dhënat e lejuara dhe të detyrueshme për publikim në zbatim të germës d) të pikës 1, të nenit 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"		
4	21.08.2020	Kërkohej informacion lidhur me hetimet disiplinore ndaj magistratëve të nisura apo përfunduara prej ILD-së dhe konkretisht: vendimin nr.313/7 prot, datë 02.04.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit M.K"; vendimin nr.251/11 prot, datë 22.05.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores E.K" ; Vendimit nr.705/1 prot, datë 22.05.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtares E.H"; Vendimin nr. 644/4	24.08.2020	Referuar nenit 100 pika 2 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ILD udhëhiqet dhe synon zbatimin e përshtatshëm, proporcional dhe në mënyrë të balancuar të parimit të drejtësisë së hapur, të ligjshmërisë, konfidencialitetit, i të drejtës për jetë private dhe i mbrojtjes së të dhënave personale. Inspektori i Lartë i drejtësisë përgjatë zhvillimit të procedurave të shqyrtimit fillestar të ankesave, verifikimit apo hetimit disiplinor i kushton një rendësi të veçantë të drejtës së informimit të publikut në funksion të administrimit të drejtësisë, por në të njëjtën kohë duhet të garantojë edhe mbrojtjen e interesave ligjore të personave të tretë, si edhe duhet të kujdeset që në kuadër të administrimit të të dhënave apo dokumenteve të mos cënohet funksioni dhe qëllimi i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>prot, datë 07.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtarit Sh.M"; vendimi nr.1751 prot, datë 16.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj gjyqtares E.H" ; vendimi nr.1752, datë 16.07.2020 "Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores B.M"; Vendimi nr.705/12 prot, datë 17.07.2020 "Për pezullim hetimi disiplinor ndaj gjyqtares E.H"; Vendimi nr.251/29 prot, datë 21.07.2020 "Për mbylljen e hetimit disiplinor ndaj prokurores E.K"</p>		<p>Drejtësisë. Për sa më sipër bazuar në kërkesat e nenit 17, pika 2, shkronja c) të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", në këtë moment nuk mund t'ju vihet ne dispozicion dokumentacioni i kërkuar.</p>		
5	10.09.2020	<p>Rivlerësimi i dhënies së informacionit të kërkuar nga kërkuesja znj. F. B., kandidate për pozicionin Ndihmës Inspektor, në Njësinë e Ndihmës Inspektorëve , pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p>	10.09.2020	<p>Komisionerit i kthehet përgjigje ku i bëhet prezent përgjigja e dhënë znj. F. B., me shkresën nr.1596/4, datë 25.08.2020, si edhe i jepen sqarimet përkatëse për çdo kërkesë, duke i vënë në dispozicion edhe kopje të njësuar të Formularit të Vlerësimit Individual të kërkueses /kandidates F.B.</p>	Përfunduar	Nuk ka
6	14.09.2020	<p>Ankuesi pretendon të ketë dërguar ankesë me</p>	14.09.2020	<p>Kthyer përgjigje ankuesit me email, duke i bashkëlidhur shkresën nr. 2007/2 prot, datë</p>	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		email tek info@ild.al, ku kërkon konfirmim për materialet e dërguara dhe nuk ka marr përgjigje		14.09.2020, ku rezulton ti jetë kthyer përgjigje zyrtare lidhur me konfirmimin për marrjen e ankesës dhe sigurimin e palës se ankesa do shqyrtohet nga ILD në përputhje me parashikimet e pjesës V, kreu iI e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si edhe parashikimet e pjesës IV, kreu I dhe III të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e Përfunduar Nuk ka qeverisjes në sistemin e drejtësisë" dhe do njoftohet për çdo vendim që do merret mbi këtë ankesë		
7	18.09.2020	Mbi kërkesën për informacion lidhur me përzgjedhjen e inspektorëve dhe ankesat e trajtuara deri më tani.	29.09.2020	"Në vijim të kërkesës nr.2039 prot. Datë 18.09.2020 ku kërkohet informacion për përzgjedhjen e inspektorëve dhe ankesat e trajtuara deri më tani nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ju vëmë në dijeni përsa më poshtë: Bazuar në nenin 209 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, jo më pak se gjysma e inspektorëve të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë magjistratë, të cilët komandohen në këtë detyrë nga KLGJ ose KLP, pjesa tjetër emërohen nga ILD sipas procedurave të përcaktuara në ligj. Referuar vendimit nr.28/2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për miratimin e strukturës organizative, organuikës dhe klasifikimit të pagave të personalit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" do të jenë 14 inspektorë magjistratë dhe 14 jomagjistratë. KLGJ me Vendimin nr 69 prot. datë 07.02.2020 ka komanduar përkohësisht si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 6 mujore magjistraten	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Znj.Marsela Pepi. KLGJ me Vendimin nr.333 datë 17.09.2020 ka vendosur zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm për Znj.Marsela Pepi. KLGJ bazuar në kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mbledhjen e datës 26.02.2020 ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione inspektorë magjistratë. në përfundim të afatit të aplikimit nuk është paraqitur asnjë kandidat. Ndërkohë KLP me vendimin e datës 31.01.2020 ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e prokurorëve për inspektorë magjistratë për 4 pozicione. KLP ka pranuar 6 kandidatura dhe aktualisht është në proces të vlerësimit të kandidaturave të paraqitura. Numri i ankesave të ardhura në ILD nga momenti i fillimit të veprimtarisë në total është 685 ankesa. Nga këto 506 ankesa të paraqitura nga qytetarët, 174 të paraqitura nga institucionet dhe 5 nga organizata jofitimprurëse. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 8 vendime për fillim/pezullim/përfundim të hetimit disiplinor. Janë dërguar në KLP/KLGJ 3 kërkesa për procedim disiplinor. Në periudhën Shkurt-Shtator 2020 janë depozituar 757 ankesa të marra nga KLGJ të prapambetura dhe 1347 praktika nga KLGJ dhe ish KLD.</p>		
8	21.09.2020	Sa është numri i inspektorëve të zgjedhur nga radhët e magjistratëve? Nëse nuk është bërë	29.09.2020	"1.Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 69, datë 07.02.2020, ka komanduar përkohësisht si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për një periudhë 6 mujore magjistraten znj.		

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

	<p>përzgjedhja e plotë , cilat janë arsyet e vonesës dhe në çfarë faze ndodhet ky proces? Kur pritet të zgjidhen plotësisht trupa e inspektorëve nga radhët e magjistratëve? 2. Sa është numri i inspektorëve të zgjedhur nga radhët e jomagjistratëve? Nëse nuk është bërë përzgjedhja e plotë, cilat janë arsyet e vonesës dhe në çfarë faze ndodhet ky proces? Kur pritet të zgjidhen plotësisht trupa e inspektorëve nga radhët e jo magjistratëve? 3. Sa është nr. i ankesave të marra nga ILD nga momenti i fillimit të veprimtarisë së tij dhe deri në momentin e marrjes së kësaj kërkesë? Informacioni kërkohet i ndarë sipas subjekteve që i kanë dërguar këto ankesa pranë ILD-së. 4. Sa prej këtyre ankesave janë trajtuar? Ka patur raste</p>		<p>Marsela Pepi. Gjithashtu, KLGJ me vendimin nr.333, datë 17.09.2020 ka vendosur zgjatjen e afatit të komandimit për znj Marsela Pepi dhe në zbatim të tij ka dal urdhri nr.62, datë 22.09.2020 i Inspektorit të Lartë Drejtësisë ""Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm deri në përfundim të proceduarave ligjore, sipas vendimit të KLGJ për znj. Marsela Pepi. Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e datës 26.02.2020, ka vendosur të hapë procedurën e komandimit nga radhët e gjyqtarëve për 6 pozicione inspektor magjistrat, në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pozicion për të cilin nuk ka patur asnjë kandidaturë. Më datë 10.07.2020 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rihapur serish procedurën e komandimit dhe nuk ka patur asnjë kandidaturë. Gjithashtu pas kërkesës nr.5/4 prot, datë 24.08.2020, të ILD-së, KLGJ ka rihapur procedurën për komandimin për 6 pozicione të lira. Afati për paraqitjen e aplikimeve është deri më 02.10.2020. Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimin e datës 31.01.2020 ka shpallur fillimin e procedurës për plotësimin e 4 (katër) pozicioneve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes procedurës së komandimit, gjithashtu ka pranuar 6 kandidatura nga prokurorë për pozicionin inspektorë magjistratë dhe aktualisht është në proces të vlerësimit të kandidaturave të paraqitura.2. Për sa i takon trupës së Inspektorëve nga radhët e jo magjistratëve</p>	
--	--	--	---	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		kur i kanë përcjellë për procedim të mëtejshëm pranë KLGJ-së dhe KLP -së? Nëse po çfarë ka ndodhur në këto raste?		zyra e ILD më datë 08.02.2020, ka shpallur hapjen e procedurën së aplikimit për pozicionin e Inspektorit jo magistratë fillimisht për 6 vende dhe është në pritje të informacioneve nga institucione të tjera në kuadër të procesit të verifikimit të figurës, integritetit dhe të pasurisë së kandidatëve në fjalë. 3. Numri i ankesave të ardhura në ILD nga momenti i fillimit të veprimtarisë së tij e deri në këtë moment në total është 685. 4. Ankesat janë trajtuar konform dispozitave ligjore në fuqi. Vlen të theksohet se pranë ILD -së janë depozituar edhe 757 ankesa të marra nga KLGJ si ankesa të prapambetura si edhe 1347 praktika, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (dhe ish -KLD), për trajtimin e të cilave me urdhrin nr. 66, datë 28.09.2020 është ngritur një grup pune, për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare, deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë		
9	01.10.2020	Kërkim informacioni mbi ecurinë e përgatitjes së projektdokumentit për programin buxhetor afatmesëm 2021-2021 për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	14.10.2020	ILD si institucion i ri i sistemit të drejtësisë , përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe inspektimin instucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë , me qëllim funksionimin e tij, kërkon infrastrukturë dhe burime njerëzore e financiare të siguruara, Që në fillimet e	Pefunduar	Nuk ka



## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>veprimtarisë , institucioni ynë është përballur me mungesë të theksuar të kushteve bazë , si përsa u përket zyrave, pajisjeve të punë (kompjuterike dhe orendi zyre), si dhe pamjaftueshmëri të fondeve buxhetore për vitin 2020 për blerjet e tyre. Për këtë arsye, mbështetur në ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshua, udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” me anë të shkresë s sonë nr.1363, datë 26.06.2020 i jemi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me kërkesë të argumentuar për shtesë të buxhetit të rishikuar të vitit 2020, të ILD: për shpenzime korente dhe për investime. Nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në zbatim të Aktit Normativ nr.28, datë 02.07.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.88/2019”, i ndryshuar, u aprovua dhe u reflektua në buxhetin e rishikuar të ILD-së për vitin 2020, shtesa e fondit në zërin 600 “Paga”. Parashikimet në programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023- Me vendimin nr.577, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave, ILD është vënë në dijeni të tavaneve të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 të miratuar për veprimtarinë e ILD-së , të cilat janë tërësisht të pamjaftueshme, për mbulimin e nevojave të studiuara dhe të mirëargumentuara për institucionin e ILD-së . Kështu në bazë të informacionit të</p>	
--	--	--	--	---	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>detajuar të përgatitur , me objekt kostimin e veprimtarive dhe përllogaritjen e nevojave në fonde rezulton se për vitin 2021, për veprimtarinë e ILD-së është i nevojshëm një buxhet prej 305,000 mijë lekë nga i cili: 1-shpenzime korente 221,000 lekë 2-shpenzime kapitale 84,000 mijë lekë . Në parashikimin për grupin e shpenzimeve korente, janë marrë parasysh , kosto financiare vjetore për shpenzimet e personelit për paga e sigurime, me një total prej 180,000 mijë lekë , si dhe kosto për mbulimin e shpenzimeve operative për aktivitetin e institucionit gjatë vitit buxhetor në shumë n 41,000 mijë lekë, të detajuar në zëra, sipas natyrës së shpenzimeve. Përsa i përket grupit të shpenzimeve kapitale, kostimi dhe përllogaritja e fondeve është bërë mbi bazën e nevojave për investime për përshtatjen e ambienteve të godinës së miratuar për ushtrimin e veprimtarisë institucionale të ILD-së me VKM-në 507, datë 24.06.2020 “Për kalimin në përgjegjësi administrative nga DAP dhe KPP tek ILD të godinës së ish-Ministrisë së Integritimit Europian”, investime lidhur me funksionimin e sistemit të regjistrimit dhe menaxhimit të dokumenteve dhe ankesave, për blerje të pajisjeve TIK (pajisje të teknologjisë së informacionit) si: kompjutera, printera, skanera, fotokopje, blerje pajisje dhe orendi zyre të përllogaritura mbi bazën e numrit të posteve të punës dhe zyrave, të përcaktuara sipas aktiviteteve dhe veprimtarive të</p>		
--	--	--	--	--	--	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

			<p>institucionit, si dhe për blerje të automjeteve të domosdoshme, kryesisht për sigurimin e mbarëvajtjes së punës së njësisë së inspektorëve. Ndërkohë në vitin 2021, me VKM-në 577, datë 22.07.2020 për veprimtarinë e ILD-së është parashikuar një buxhet në total prej 195,000 mijë lekë nga i cili: 1- shpenzime korente 193,000 mijë lekë ; -shpenzime kapitale 2,000 lmijë lekë. Nga krahasimi i nevojave të institucionit për fonde, kundrejt tavaneve të miratuara, rezulton një diferencë e konsiderueshme, e cila përbën një risk me impakt të lartë negativ në arritjen e objektivave dhe qëllimeve strategjike të ILD-së , Me argumentet e më sipërme ILD i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rishikim të tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2021-2023 për institucionin e ILD-së . Po ashtu në mbështetje të ligjit 9936/2008, të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA”, si dhe në zbatim të udhëzimit plotësues nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023 “ me shkresë n nr.1838/1 prot., datë 01.09.2020 kemi depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesat buxhetore në shumë n 110,000 mijë lekë të ILD-së për PBA 2021-2023, si dhe kërkesat brenda tavaneve buxhetore sipas formateve standarde bashkëlidhur udhëzimit plotësues nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”.</p>	
--	--	--	--	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

10	15.10.2020	Kërkohet informacion mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në aspektin financiar, logjistik e infrastrukturor.	28.10.2020	<p>Fondi i pamjaftueshëm i alokuar për ILD-në si një institucion krejt I ri, ka vështirësuar procesin e punës dhe 9 muaj nga nisja e funksionimit institucioni është ende në proces plotësimi të mungesave thelbësore logjistike me pajisje pune. Pritshmëritë e institucionit janë që buxheti i vitit të ardhshëm të kompensojë dhe pasqyrojë nevojat e ILD-së për vitin e ardhshëm. Në 7 muajt e parë prej ngritjes së tij, ILD ka funksionuar vetëm me një zyre e vendosur në ambientet e kohës së KLGJ-së, me një staf tejet të ngushtë edhe për shkak të infrastrukturës së munguar. Pas evidentimit të përsëritur zyrtar të kësaj problematike Këshilli i Ministrave miratoi ambiente të reja pune për ILD-në me VKM-në nr.507, datë 24.06.2020 "Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë të godinës së ish Ministrisë së Integritimit Evropian". Inspektori i Lartë i Drejtësisë është në pritje të komandimit nga KLGJ e KLP të inspektorëve magjistratë, pasi që nga fillimi i punës ka vetëm një inspektor magjistratë të komanduar nga KLGJ bazuar në nenin 209 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Nuk ka patur interesim pas thirrjeve të KLGJ për inspektor magjistratë gjyqtarë, ndërsa KLP është në proces vlerësimi të kandidatëve që kanë shpallur interes për inspektorë magjistratë prokurorë. Zyra e ILD-së ka vijuar procesin e rekrutimit të inspektorëve</p>	Përfunduar	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	------------	--------

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				jo magjistratë në zbatim të VKM-së nr.536, datë 25.07.2019 "Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kritereve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit". Procesi i rekrutimit për plotësimin e stafit të ILD-së është drejt përfundimit dhe çdo etapë e tij është e pasqyruar edhe në faqen zyrtare të institucionit, e në respekt të protokolleve të mbrojtjes nga Covid -19.		
11	15.10.2020	Kërkohet informacion mbi qëndrimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me rastin e publikuar nga e A. L. C. N. A.	28.10.2020	Inspektori I Lartë I Drejtësisë bën me dije se informacioni i paraqitur nga ana juaj në lidhje me veprimet apo mosveprimet e A.T, me detyrë anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor do shqyrtohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përputhje me parashikimet e nenit 5 dhe 6, të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe pjesës V, Kreu II, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Përfunduar	Nuk ka
12	21.10.2020	Kërkohet informacion lidhur me qëndrimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me një rast që po trajtohet.	28.10.2020	Siç është bërë e ditur edhe nëpërmjet komunikimit publik, prioritet i punës së Zyrës së ILD është vlerësimi me seriozitet i të gjitha pretendimeve të paraqitura nga personat fizik dhe juridikë lidhur me veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit brenda dhe jashtë funksionit të tij, në ekuilibër midis parimeve të interesit publik për administrimin e drejtësisë, parimit të ligjshmërisë, gjykimit të drejtë e të paanshëm si edhe atij të ndarjes së pushteteve. Për sa më sipër informacioni i	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				paraqitur lidhur me veprimet apo mosveprimet e magjistratit M.Ll do të shqyrtohen nga ILD në përputhje me parashikimet e pjesës V, Kreu II, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.		
13	10.12.2020	Kërkohet vënia në dispozicion e akteve të nxjerra ose që do të nxirren nga ILD në kuadër të verifikimit të informacionit të paraqitur për gjyqtaren E.V.	11.12.2020 05.01.2020 (vijim i përgjigjes së datës 11.12.2020)	<p>Bashkëlidhur është vënë në dispozicion:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkresa nr.5632, datë 01.12.2020 i Gjykatës së Apelit Tiranë;</li> <li>- Vendimi nr.2916/2, datë 07.12.2020 të LD-së "Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar të informacionit të paraqitur nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë R.H.</li> <li>- Shkresa nr.2916/3, datë 09.12.2020 drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë</li> <li>- Shkresa nr.2916/4, datë 09.12.2020 drejtuar KLGJ-së. Pas marrjes së informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar do të vlerësohet në përputhje me parashikimet e ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nëse ka vend për fillimin e hetimit disiplinor.</li> </ul> <p>Në vijim të shkrësës së dërguar nga zyra e Inspektorit të Lartë të drejtësisë, në kuadër të verifikimit të informacionit të paraqitur është dërguar vendimi nr.2916/8, datë 05.01.2021 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.</p>	Përfunduar	Nuk ka
14	10.12.2020	Në zbatim të nenit 119, datë 18.09.2014	16.12.2020	Bazuar në nenin 147/d të Kushtetutës dhe nenin 194 të, pika 1 e ligjit nr. 115/2016	Përfunduar	Nuk ka

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>kërkohet informacioni: ILD përveç ankesave ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve a trajton ankesa të tjera? Në rastin e konfliktit të interesit çfarë procedure ndiqet? A kryen inspektime në administratën gjyqësore dhe nëse po, në cilat raste kryhen inspektime dhe në cilat gjykata ka kryer inspektime?</p>		<p>“Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Lidhur me procedurën që ndjek ILD në rastet e konfliktit të interesit sqarohet se, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në cilësinë e një institucioni të pavarur kushtetues ushtron veprimtarinë e saj në respektim dhe në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm në republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të saj dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Në rast të konstatimit të situatave të konfliktit të interesit apo të pengesave ligjore, sipas kuptimit dhe rasteve të parashikuara nga K. Pr. Administrative dhe legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike do të veprohet në përputhje me parashikimet e këtyre akteve ligjore. Në lidhje me informacionin mbi rastet e kryerje së inspektimeve në administratën gjyqësore dhe pranë cilave gjykata janë kryer inspektime sqarohet se, bazuar në</p>	
--	--	--	--	---	--

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>parashikimet e nenit 194, pika 4 e ligjit 115/2016, ILD kryen inspektime institucionale dhe tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyra të prokurorisë dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të KLGJ-së, të KLP-së, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve. Aktualisht ILD pavarësisht sfidave të hasura që në fillim të punës, si mungesa e burimeve njerëzore, situata e shkaktuar nga pandemia COVID-19 apo edhe numri i lartë i ankesave të mbartura nga institucionet e tjera ka nisur përmbushjen e një pjese të konsiderueshme të detyrimeve ligjore. Në këtë kuadër, zyra e ILD-së është në fazën e identifikimit të problematikave në punën e gjykatave dhe zyra të prokurorisë dhe administratave përkatëse, të cilat do të bëhen pjesë e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike që do të miratohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me qëllimin parësor rritjen dhe konsolidimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.</p>		
--	--	--	--	---	--	--